

**QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE
ZHVILLIMIN**



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

+04 2 251475 / www.acpd.org.al

RAPORTI | 2018 **VJETOR**



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT



Lista e Pogramit dhe aktiviteve

Titulli: Për një qasje ndaj HIV dhe SIDA pa stigma, të ndjeshme ndaj gjinisë për popullatat kyçe – (financuar nga) IPPF.....	4
Titulli: Le të sfidojmë stigmën ndaj abortit dhe të veprojme – (financuar nga) IPPF.....	5
Titulli: Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve për një jetë të lirë fiziko-seksuale dhe emocionale (ESGJ) – (Financuar nga) IPPF.....	7
Titulli: Fuqizimi i adoleshentëve për të vepruar mbi të drejtat e tyre në zonat rurale të Tiranës dhe Shkodrës – (financuar nga) Save the Children.....	9
Titulli: Speak It Out Loud – Veprime të përbashkëta për parandalimin dhe përgjigjen ndaj Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës Seksuale ndaj grupeve vulnerabël, përfshirë komunitetin Rom dhe Egjiptian– (Financuar nga) IPPF.....	10
Titulli: Parandalimi dhe kontrolli i Kancerit të Qafës së Mitrës në Shqipëri – (financuar nga) IPPF	14
Titulli: Vajzat dhe gratë e zonave rurale faktorë ndryshimi në komunitet – (financuar nga) Olof Palme	12
Titulli: Ofrimi i Shërbimeve për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Situata Emergjente dhe Kriza Humanitare (MISP) – (financuar nga) UNFPA	16
Titulli i projektit: Gatishmëria e sistemit të kujdesit shëndetësor për të ofruar MISP në situatat emergjente të shëndetit riprodhues (MISP) - (financuar nga) IPPF.....	18
Titulli: Forcimi i reagimit kombëtar në trajtimin e çështjeve që lidhen me HIV, AIDS dhe IST: Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për të përmirësuar shëndetin, të drejtat seksuale dhe riprodhuese të të rinjve– (financuar nga) UNFPA.....	19
Titulli: Forcimi i sistemit shëndetësor për ofrimin e aksesit të barabartë ndaj shërbimeve cilësore të integruara të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues në nivel kombëtar dhe lokal dhe në mjedise humanitare – (financuar nga) UNFPA.....	21
Titulli: Organizimi i tryezës së rrumbullakët të Udhezuesit Teknik Nderkombëtar (ITG)-së dhe grupit të ekspertëve, ku vërejtjet / sugjerimet nga ITG-ja u prezantuan me pjesëmarrjen e agjencive të Kombeve të Bashkuara. / Dorëzimi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – (financuar nga) UNFPA.....	23
Titulli: Trajnimi online mbi planifikimin familjar – (financuar nga) UNFPA.....	24
Shërbimet Klinike	25
Të Ardhurat.....	26

Titulli: Për një qasjendaj HIV dhe SIDA pa stigma, tëndjeshmendajgjinisë për popullatat kyçe – (financuar nga) IPPF

Qëllimi:

Burrat dhe gratë, vajzat dhe djemtë kanë qasje të barabartë në parandalimin e HIV/AIDS, shërbime të kujdesit dhe trajtimit të përballueshëm dhe cilësor. Projekti do të kontribuojë në balancimin e pabarazive në qasjen ndaj kujdesit dhe në cilësinë e kujdesit në lidhje me stigmatizmin dhe diskriminimin e drejtuar ndaj grupeve të rrezikuara në një periudhë kohore prej tre vjetësh, duke mbuluar katër rrethe të mëdha të Shqipërisë ku kryesisht epidemia e HIV është e përqendruar: Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Vlorë.

➤ **Rezultatet e Aktiviteteve**

- 25 persona kanë përmirësuar njohuritë e tyre dhe janë pajisur përmes trajnimeve me njohuri dhe shkathtësi mbi çështjet që lidhen me HIV / AIDS, abuzimin e substancave, orientimin seksual dhe diskriminimin ndaj grupeve të prekshme dhe popullatave kyçe.
- Ekipi kryesor prej 25 persona, i përbërë nga stafi i drejtorisë së shëndetit publik në Vlorë, punëtorët e kontaktit, ofruesit e shërbimeve dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe edukatorët e moshatarëve, është krijuar për të ofruar trajnime mbi temat e HIV/AIDS. Ata kanë të gjitha aftësitë tani për të ofruar trajnime për ofruesit e tjerë të shërbimeve ose për të ndarë informacionin me kolegët e tyre dhe ta përdorin atë në fushatat e ndërgjegjësimit



Titulli: Le të sfidojmë stigmën ndaj abortit dhe të ndërmarrim veprime – (financuar nga) IPPF

Qëllimi:

Komuniteti në përgjithësi, qeveria, politikëbërësit dhe mediat njohin mundësinë e abortit të sigurt dhe ligjor si një të drejtë njerëzore për gratë në Shqipëri

➤ Rezultatet e Aktiviteteve

- Një video mesazh i titulluar "I lirë nga shtrëngimi riprodhues" është zhvilluar nga një ekip i përbërë nga stafi, dy ekspertë të komunikimit dhe dy gra, aktivistë të projektit. Është publikuar / promovuar përmes medias sociale dhe rrjetit të Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QSHPZH).
- 600 njerëz u arritën si rezultat i promovimit të videove (përmes medias sociale, aktiviteteve edukative).



- 32 gra dhe burra të rinj, mbështetës të grave që kanë kryer aborte, duke përfshirë partnerë, familje dhe miq, si dhe avokuesit e abortit u mblodhën në seminarin njëditor për të diskutuar mbi stigmën ndaj abortit dhe ndikimin e saj në jetën e grave dhe barrën e saj për shëndetin e tyre.

- Një trajnim dy ditor me 20 ofrues të kujdesit shëndetësor (gjinekolog, mami, mjekë të përgjithshëm dhe infermierë) për shërbime e abortit të sigurt, ligjor dhe pa stigmë, u krye në Vorë (zona rrethuese e Tiranës). Vlerësimi tregoi se qëndrimet e pjesëmarrësve ndaj abortit janë përmirësuar. Shumë prej tyre raportuan përsëri për fillimin e praktikimit të ofrimit të shërbimeve pa stigmë dhe për ndarjen e njohurive dhe informacionit të fituar me kolegë të tjerë (rreth dhjetë seanca informale u kryen, duke arritur 80 ofrues të tjerë të shërbimeve).

- 500 individë të të gjitha moshave u arritën me mesazhe (nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë dhe / ose medias sociale) për të mbështetur të drejtën e grave për një jetë riprodhuese të lirë dhe për të respektuar të drejtën e tyre për të vendosur lirisht mbi trupat e tyre, kur të kenë fëmijë dhe të drejtën për integritet trupor dhe autonomi.
- 1048 shërbime të abortit (pa përfshirë rastet e referimeve) janë siguruar nga klinikat e QSHPZH përfshirë klinikat statike, klinikat e lëvizshme dhe shërbimet e ofruara në komunitet
- Mund të ndiqni videon në Youtube: <https://www.youtube.com/watch?v=DjWQguwbf1c&t=17s>



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHYVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Titulli: Fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve për një jetë të lirë fiziko-seksuale dhe emocionale - (financuar nga) IPPF

Qëllimi: Fëmijët dhe të rinjtë e moshës 10-24 vjeç në Shqipëri kanë shkathtësinë e nevojshme shëndetësore dhe aftësinë për të marrë vendime të informuara dhe të angazhohen në marrëdhënie të lumtura, të shëndetshme dhe përmbytëse

➤ Rezultatet e aktiviteteve

- 125 të rinj u trajnuan si edukatorë të bashkëmoshatarëve. Si rezultat, ata e shpërndan informacionin mes të rinjve në shkolla dhe tek grupet vulnerable:
- 710 të rinj u arritën me zhvillimin e një pjese të programit të Edukimit Seksual Gjithëpërfshirës (ESGJ).



- 100 të rinj u arritën me zhvillimin e plotë të programit të ESGJ-së.
- Format e vlerësimit të cilat synonin reagimet direkte të rinjve, treguan se 80% e grupeve në nevojë (500 në total) duke përfshirë popullatën kyçe (PK) përfituan njohuritë dhe aftësitë e nevojshme.
- 70% e tyre filluan të praktikojnë sjellje të shëndetshme mbi seksualitetin dhe marrëdhëniet, përmes përdorimit të prezervativëve, testit për HIV/AIDS, vizitave në klinika dhe perms ofrimit të këshillimit nga profesionistët shëndetësor; duke nisur një komunikim të hapur me prindërit e tyre në lidhje me orientimin e tyre seksual, etj.
- 60 të rinj pjesëmarrës në forumet e organizuara morën njohuri dhe përmirësuan qëndrimet lidhur me të drejtat e njeriut, qasjet transformuese gjinore, seksualitetin pozitiv. Ata janë bërë aktivistë të QSHPPZH-së që angazhohen në sesionet e edukimit të bashkëmoshatarëve, dizenjimin dhe shpërndarjen e produkteve të rrjeteve sociale, duke sjellë aktivistë të tjerë në qendrat e QSHPPZH (10 aktivistë të rinj) dhe duke iu referuar të rinjve për të marrë shërbime Shëndetit Riprodhues në klinikat e QSHPPZH-së.
- 125 edukatorë të rritur janë trajnuar për të ofruar trajnime cilësore të ESGJ-së për edukatorët e tjerë.
- 200 mësuesve iu mundësua me edukimi seksual dhe aplikuan njohuritë dhe informacionin e marrë mbi komponentët e ndjeshëm në ofrimin e ESGJ-së "seksi pozitiv, kënaqësitë, aborti dhe dhuna seksuale.

- 400 persona nga Tirana, Vlora dhe Shkodra janë arritur përmes mesazheve të akspojuara gjatë konferencës, si dhe nëpërmjet promovimit të tyre përmes medias sociale etj.
- 20.100 të rinj dhe të rritur janë arritur në fushatën e medias sociale me mesazhe pozitive rreth ESGJ-së.
- 120 anëtarë të komunitetit dhe prindër kanë qenë pjesë e diskutimeve dhe janë ndërgjegjësuar për përfitimet e ESGJ-së në jetën e të rinjve.
- Programi i ESGJ-së i QSHPHZ-së është rishikuar përmes mjetit “Insideandout” me qëllim sigurimin e cilësisë së ofrimit; koeficienti gjithëpërfshirës ishte 97%. Janë krijuar 20 partneritete me organizatat rinore, organizata të tjera dhe institucione që kontribuan në rezultatet e projektit. Memorandum bashkëpunimi u nënshkrua me institucione të reja duke përfshirë 5 shkolla.
- Konferenca përmbyllëse e projektit mbi Edukimin Seksual Gjithëpërfshirës ka shërbyer për të ndërtuar rrjete në mesin e përfaqësuesve të ndryshëm nga Institucionet Shtetërore (5), OJF-ve (8), (4) media dhe komuniteti (13) duke prodhuar një plan vazhdues për strategjitë dhe qasjet e ardhshme në lidhje me avancimin e Edukimit Seksual Gjithëpërfshirës dhe Shëndetin Riprodhues në vend.



QENDRA SHQIPTARE
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT



Titulli: Fuqizimi i adoleshentëve për të vepruar mbi të drejtat e tyre në zonat rurale të Tiranës dhe Shkodrës – (financuar nga) Save the Children

Qëllimi:

Qëllimi i këtij projekti është rritja e informacionit dhe njohuritë e mësuesve, nxënësve dhe komunitetit mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Trafikimin Njerëzor dhe edukimi i tyre për të drejtat ligjore për fshirë të drejtë kundër trafikimit njerëzor.

➤ Rezultatet e Aktiviteteve

- 60 mësues janë trajnuar për të Drejtat e Fëmijëve dhe Trafikimin Njerëzor dhe si ta shpërndajnë këtë informacion tek nxënësit.
- 400 nxënës kanë marrë pjesë në forumet e diskutimit të organizuara në shkollat 9-vjeçare të zonave rurale të Tiranës dhe Shkodrës.
- 200 nxënës janë informuar për të Drejtat e Fëmijëve dhe Trafikimin gjatë sesioneve informuese të zhvilluara nga mësuesit e trajnuar në zonat periferike të Tiranës dhe Shkodrës





QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHYVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Titulli: *Speak It Out Loud*-Veprime të përbashkëta për parandalimin dhe përgjigjen ndaj Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës Seksuale ndaj grupeve në nevojë, përfshirë komunitetin Rom dhe Egjiptian- (Financuar nga) IPPF

➤ Rezultatet e aktiviteteve

- 50 ofrues të shërbimeve (nga Vlora dhe Shkodra) kanë përfituar informacion, aftësi teknike për DHBGJ dhe mekanizmin e referimit, me qëllim që të ofrojnë mbështetje të sigurt mjekësore dhe emocionale për vajzat dhe gratë viktime të mbijetuara të dhunës
- 500 kopje të manualit "Një qasje praktike ndaj dhunës me bazë gjinore" janë publikuar dhe shpërndarë tek ofruesit e kujdesit shëndetësor
- 120 gra dhe vajza kanë marrë falas këshillim psikologjik në kliniken e QSHPPZH për çështjet e DHBGJ. 15 prej tyre janë referuar në institucione të tjera të Mekanizmit Referues siç janë Policia dhe Organizata "Vatra".
- Paketa e shërbimeve të integruara në Qendrën Aulona është e pasuruar duke ofruar jo vetëm shërbimet e SHSR por edhe shërbimet psiko-sociale për gratë në nevojë.
- 60 udhëheqës dhe anëtarë të komunitetit dhe aktivist të shoqërisë civile janë bërë të vetëdijshëm dhe kanë përmirësuar komunikimin midis tyre në mënyrë që të adresohen më mirë dhuna seksuale me bazë gjinore dhe dhuna në familje. Projekti gjithashtu ka forcuar bashkëpunimin dhe ka përmirësuar komunikimin ndërmjet të gjithë anëtarëve të Mekanizmit Referues të DHBGJ në Vlorë dhe në zonën e Shkodrës.



- 50 djem nga zonat rurale të Novoselës, Orikumit, Dajcit dhe Rajonit numër 4 në Shkodër janë trajnuar për t'u bërë anëtarë aktivë të grupit COMBAT dhe janë të përfshirë në fushatat ndërgjegjësuere në komunitetet e tyre përkatëse.
- 1000 kopje të fletëpalosjes kundër bulling-ut në mes të kolegëve janë shpërndarë në fushatat ndërgjegjësuere në zonat e projektit dhe në shkollat përkatëse.
- 20,000 njerëz janë arritur me mesazhe ndërgjegjësuere për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe sidomos objektivin numër 5 në lidhje me DHBGJ, kundër dhunës në familje, martesave të hershme dhe rolin e burrave dhe djemve si pjesë e zgjidhjes, përmes fushatave ndërgjegjësuere dhe teatrit "Një ëndërr e shkelur" të zhvilluar në Teatrin e Vlorës dhe Shkodrës me rastin e 16 ditëve të aktivizmit kundër DHBGJ.



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHYVILLIMIN

- Shfaqja e teatrit ishte një mjet i suksesshëm për rritjen e ndërgjegjësimit të 600 personave (500 në Vlorë dhe 100 në Shkodër) të rinjve dhe liderëve të komunitetit rreth DHBGJ dhe martesave të detyruara / të hershme.

Titulli: Mbrojtja e jetës së grave nga kanceri i qafës së mitrës – (financuar nga) IPPF

Qëllimi:

Projekti 2016-2017 i kancerit të qafës së mitrës në Shqipëri synoi përmirësimin dhe rritjen e aksesit ndaj shfaqjes së kancerit të qafës së mitrës dhe trajtimin e lezimeve precancerous në mesin e grave 30-49 vjet. Qëllimi për këtë iniciativë kete vit i QSHPH do të jetë integrimi i avokimit të tij për futjen e VIA (të paktën në zonat rurale), në përpjekjet e përgjithshme të avokimit për një plan kombëtar të shqyrtimit.

➤ Rezultatet e aktiviteteve


- 12 takime u organizuan nga stafi i projektit me udhëheqësit e komunitetit dhe punonjësit e shëndetësisë (60 persona). Në përputhje me partneritetet e vendosura, bashkëpunëtorët kanë qenë të përfshirë në promovimin e VIA (inspektimi vizual me acetik), informacionit fillestar për parandalimin e kancerit, rekrutimin e pjesëmarrësve të aktivitetit etj.
- 480 gra janë arritur përmes klinikave të lëvizshme; 750 gra kanë kryer VIA. Në total 3274 gra kanë përfituar shërbimin.
- 2000 gra (të cilët vizituan klinikat e QSHPH) janë informuar për depistimin e kancerit të qafës së mitrës përmes aktiviteteve ndërgjegjësuëse, aktiviteteve të komunitetit dhe aktiviteteve edukative.



- Rreth 111.200 njerëz janë arritur me mesazhe pozitive rreth kontrollit të kancerit të qafës së mitrës, parandalimit dhe trajtimit përmes aktiviteteve edukative dhe ndërgjegjësuëse dhe medias sociale. "Ne mundemi, Une mundem"; "Të testohen për të parandaluar kancerin e qafës së mitrës" ishin slloganet kryesore të eventeve të ndërgjegjësimit të zhvilluara në Vlorë dhe në Tiranë.

- Një TV lokal ka transmetuar një nga eventet në Vlorë përmes edicionit kryesor të lajmeve duke i dhënë jehonë përpjekjeve të QSHPH-së drejt shëndetit të grave në Shqipëri me mbështetjen e IPPF.
- 520 të rinj në moshën 9-13 vjeç janë bërë të vetëdijshëm se si të mbrojnë veten përmes vaksinës HPV dhe metoda të tjera të depistimit.

- 390 gra të banuara në zonat rurale, gratë dhe burrat nga komuniteti rom dhe të tjerët nga Popullata Kyçe (LGBT, punonjësit e seksit, IDU etj.) kanë fituar njohuritë lidhur me parandalimin e kancerit cervikal (CC).
- 70 ofrues të kujdesit shëndetësor (gjinekologët, mamitë, infermierët, menaxherët e kujdesit shëndetësor parësor, përfaqësuesit e OSHC-ve dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor mendor) me bazë në 6 rajone të Shqipërisë janë trajnuar për VIA, krioterapia dhe avokimi.
- 1119 persona janë arritur nëpërmjet videosndërgjegjësuere të prodhuara në kuadër të këtij projekti: <https://www.youtube.com/watch?v=O7ZwuKyj9AQ&t=221s>



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHYVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Titulli: Vajzat dhe gratë e zonave rurale faktorë ndryshimi në komunitet – (financuar nga) Olof Palme

Qëllimi:

Mundësimi i grave të punësuar në fasoneri të promovojnë të drejtat e punës dhe dialogun social.

➤ Rezultatet e aktiviteteve



- **186 gra të punësuar** kanë rritur njohuritë rreth të drejtave të punës dhe kodit të punës gjatë 8 seminareve të zhvilluara me gra dhe vajza të punësuar.

- **1900 gra të punësuar** kanë rritur njohuritë mbi të drejtat e tyre dhe përgjegjësitë e punëdhënësve nëpërmjet **fletëpalosjeve** të shpërndara në dhjetë fasoneri të ndryshme në rrethin e Vlorës.

- U bë një apel drejtuar **1500 grave punëtore** për të luftuar për të drejtat e tyre në punë përmes **posterave** të vendosur në sallën e fabrikave të tyre me mbështetjen e Inspektoratit të Punës.
- Është rritur ndërgjegjësimi i përafërsisht **20000 personave** që kanë ndjekur **katër transmetimet televizive** (promovimin e të drejtave të punës dhe avokimin për të drejtat e grave në ditët ndërkombëtare, të transmetuara në Real TV, 6 + 1Vlora, One TV dhe në mediat sociale) si dhe përmes **videos së shkurtër** që promovon rezultatet dhe gjetjet e studimit Bazë.
- **Studimi bazë** zbuloi gjetje të rëndësishme dhe rekomandime që do të adresoheshin në të ardhmen nga institucionet shtetërore dhe nga bizneset private.
- Është themeluar për herë të parë **Aleanca për të Drejtat e Punës** në Vlorë me përfaqësuesit e OJF-ve dhe institucioneve shtetërore që merren me çështjet e të drejtave të grave. Gjithsej 8 përfaqësues të OJF-ve dhe aktorë të tjerë janë intervistuar nga mediat në fushata për të drejtat e punës së grave gjatë vitit 2018. Qendra QSHPHZ / Aulona përforcon koalicionin ekzistues me organizata të tjera të shoqërisë civile në Vlorë për të maksimizuar ndikimin.

- **130 gra dhe vajza** të punësuar në fasoneri kanë përfituar drejtpërsëdrejti nga **shërbimet psikosociale** të ofruara nga stafi i Qendrës Aulona.
- **79 gra** të punësuar në fasoneri kanë marrë **shërbime shëndetësore falas** në Qendrën Aulona.
- **4 gra** punëtore janë ndihmuar individualisht me çështje të sigurimeve shoqërore dhe lejeve të lindjes.
- **Aleanca e Grave Këshilltare të Bashkisë** së Vlorës është sensibilizuar për nevojat e grave në fasoneri.
- Janë themeluar **dy Komitete Shëndetësore dhe të Sigurisë** në dy fasoneri të Vlorës (Romar dhe TomaificioMaro).
- **120 gra punëtore** për herë të parë në jetën e tyre kanë votuar për përfaqësuesit e tyre në Komitetet e Shëndetit dhe Sigurisë përmes procesit të krijimit të Komiteteve të Shëndetit dhe Sigurisë.



- **Stafi i QSHPHZ-së** ka fituar njohuri për detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit lokal të punës dhe për kryerjen e monitorimit efektiv. Stafi i ACPD / Aulona ka fituar aftësi gjatë periudhës raportuese lidhur me rolin e Inspektoratit të Punës dhe Zyrës së Punës përmes disa takimeve të organizuara me drejtorin e këtyre zyrave dhe inspektorët e fabrikave të këpucëve, si dhe përmes diskutimeve të fokus grupeve me gratë punëtore dhe intervistat.

- **Qendra Aulona ka fituar njohje në komunitetin e fasonerive** të Vlorës si një organizatë që punon për mbrojtjen e të drejtave të tyre.
- Gjithësej **332 gra dhe vajza** janë intervistuar (si pjesë e studimit bazë), kanë marrë pjesë në diskutimet e fokus grupeve dhe në ëorkshops për të drejtat e punës. Të gjithë pjesëmarrësit janë pajisur me një kupon për shërbime psiko-sociale dhe të shëndetit riprodhues falas në Qendrën Aulona.

Titulli: Ofrimi i Shërbimeve për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Situata Emergjente dhe Kriza Humanitare (MISP); Zhvillimi i Trajnimeve për MISP në Pogradec, Fier dhe Lezhë – (financuar nga) UNFPA

Qëllimi:

Fuqizimi i kapaciteteve të ofruesve të kujdesit shëndetësor në katër rrethe të Shqipërisë për të qenë të gatshëm ti përgjigjen nevojave të shëndetit riprodhues në situatë emergjence apo krize humanitare.

➤ Rezultatet e Aktiviteteve

- 70 ofrues të kujdesit shëndetësor janë trajnuar mbi MISP në rrethet si Shkodër, Fier dhe Lezhë me qëllim rritjen e njohurive të ofruesve të kujdesit shëndetësor në shërbimet prioritare të shëndetit riprodhues në mënyrë që të jenë të gatshëm ti përgjigjen nevojave të shëndetit riprodhues në situatë emergjence apo krize humanitare.



NE DHE ZHYLLIMIN
AND DEVELOPMENT



Rekomandime:

- Më shumë ofrues të kujdesit shëndetësor duhet të trajnohen për dhunën me bazë gjinore, Parandalimin dhe Kontrollin e HIV-it, Trajnimin mbi Infeksionet Seksualisht të Trasmetueshme, Trajnimin mbi Masat Parandaluese Universale, Ndjekjen e Grave Shtatzëna, Çështjet e kujdesit Post natal të grave, Kujdesin Shëndetësor dhe mirërritjen e fëmijëve.
- Njohja e Protokolleve të Transfuzionit dhe Siguria e Gjakut, masat paraprake standarde dhe zbatimi i tyre.
- Më shumë vëmendje duhet të ketë mbi çështjet e të drejtave të Shëndetit Riprodhues nga politik-bërësit dhe aktorët e tjerë.
- Të gjitha boshllëqet e kujdesit shëndetësor parësor mbi të Drejtat e Shëndetit Riprodhues duhet të përmbushen në punën e përditshme, në mënyrë që t'i përgjigjen më mirë krizave humanitare ose emergjencave.

Titulli: Gadishmëria e sistemit të kujdesit shëndetësor për të ofruar MISP në situatat emergjente të shëndetit riprodhues – financiar nga IPPF

Qëllimi:

Fokusi është forcimi i kapaciteteve të autoriteteve lokale në pesë rrethe për përgatitjen e emergjencave dhe reagimin në lidhje me SHSR / DHBGJ. Trajnimi i ofruesve të kujdesit shëndetësor parësor në rrethet e Kukësit, Tropojës, Dibrës, Bulqizës dhe Matit në MISP.

Rezultatet:

- 180 ofruesve të kujdesit shëndetësor i janë forcuar dhe përmirësuar kapacitetet
- 4000 kopje të "mëmësi esigurtë në situata të emergjencës" iu shpërndanë njerëzve të komunitetit në zonat në rrezik të përmytjeve dhe bllokimit të borës



- SOP-të për GBV për ofrimin e shërbimeve nga punonjësit e shëndetësisë në emergjencat civile janë plotësuar dhe janë përfshirë në paketën me të gjitha Procedurat Standarte të Operimit (SOPs) për rastet e DHBGJ-së të dorëzuara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tu konsideruar dhe adaptuar në vitin 2018
- 17 OJF lokale të rretheve të Vlorës dhe Shkodrës kanë rritur kapacitetet e tyre për të ofruar MISP (Paketa Minimale e Shërbimit Fillestar) të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues (SHSR) në situatë krize dhe emergjence.



Title: Forcimi i reagimit kombëtar në trajtimin e çështjeve që lidhen me HIV/AIDS dhe IST: KRIJIMI I NJË MJEDISI TË PËRSHTATSHËM PËR TË PËRMIRËSUAR SHËNDETIN, TË DREJTAT SEKSUALE DHE RIPRODHUESE TË TË RINJVE - (financuar nga) UNFPA

Në bashkëpunim me Aksion + dhe Stop AIDS, QSHPZH-ja, ka punuar për të arritur këtë objektiv:



- Në bazë të hartës rezulton se mosha e arritur e përdoruesve të drogës vazhdon të jetë nga 19 deri në 40 vjeç, por shumica e tyre i përkasin moshës nën 25 vjeç. Gjatë periudhës së raportimit, në zonat e spikatura të injektimit u hasën tre klientë të cilët ishin nën moshën 18 vjeç. Shumica e përdoruesve të drogës injektojnë në grupe të vogla (2-3 persona) dhe shumica e tyre kalojnë disa minuta në vend pas marrjes të dozës (veçanërisht atyre që injektojnë drogë).

- Llojet e drogës të përdorura: për shkak të natyrës së klientëve të arritur (përdoruesit e drogës me injektim), lloji kryesor i drogës i përdorur në vend është heroina (vetëm ose e kombinuar me lloje të tjera) pasuar nga hashashi. Lista e zonave të mbuluara nga programi gjatë periudhës së raportimit janë paraqitur si më poshtë: - Ish poligoni Ushtarak i Qitjeve (afër zonës së Alliasit) - Ura e Lanës (afër Maternitetit nr.1) - Ish shtëpia e tëmoshuarve përballë spitalit “Nënë Tereza” - Ish zona "Tekstil Kombinat" - Bregu i lumit (komuniteti rom) - Shtëpitë e përdoruesve të drogës me injektim-Aktivitetet e reduktimit të rrezikut me përdoruesit e drogës.



- Ekipi i programit ka arritur 438 klientë, ku 376 ishin përdorues të drogave me injeksion (përdoruesit e heroinës) dhe pjesa tjetër ishin tymues (përdoruesit e marihuanës dhe heroinës). Nga 438 klientë, 92 prej tyre raportuan se ishin të përfshirë në aktivitetet e MSM ose punonjës seksi
- Të gjithë klientët e arritur janë testuar për HIV / Hepatit B dhe kanë marrë seanca këshillimi para dhe pas. Përveç kësaj, 85 trajtime të plagëve janë kryer në Qendrën Drop-in
- 65 përdorues të drogës; Në bashkëpunim me ASHR (Tiranë), janë realizuar teste gjaku për klientët (rreth 65 persona, përdorues droge, punëtorë seksi / Mashkull = 58, Femër = 7), si dhe duke iu referuar rasteve të infektuarve, raste në shërbimet përkatëse.

- 180 persona janë arritur gjatë fushatave ndërgjegjëse me përfituesit e Aksion Plus (përdoruesit e rinj të drogës, punonjësit e seksit, LGBT, komuniteti romë)



- 25 përfitues janë arritur nga sesionet edukuese me të rinjtë nga grupet në nevojë cilët janë përfitues në 6 qendra.
- Teste gjakupërklientët (rreth 65 persona, përdoruesdroge, punonjësit e seksit / Mashkull = 58, Femër = 7).) Për HIV dhe HCV, sidhe duke referuarrastetëinfektuar anëshërbimetpërkatëse.



Rekomandime:

- Rritja e cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe psikosociale për klientët tanë.

- Ofrimi i shërbimeve për një gamë më të gjerë të popullsisë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të popullatës së gjerë për të qenë miqësore dhe jo për të demonstruar stigmën, por të ofrojnë ndihmën e tyre për këtë komunitet.
- Rritja e bashkëpunimit me OJF-të partnere dhe institucionet shtetërore



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHYVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

Titulli: Forcimi i sistemit shëndetësor për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet cilësore të integruara të Shëndetit Riprodhues në nivel kombëtar dhe lokal dhe në mjediset humanitare – (financuar nga) UNFPA

➤ **DY TRAJNIME DY-DITORE MBI ZHVILLIMIN E UDHËRRËFYESËVE KLINIKE**

34 ofrues shërbimi morën pjesë në dy trajnime dy-ditore mbi zhvillimin e udhërrëfyesëve klinike të zhvilluara në Tiranë dhe në qytetin e Vlorës. Fokusi i kursit ishte në Udhëzuesët Klinik mbi Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në mënyrë që të ketë ndikim maksimal në mesin e profesionistëve.

Qëllimi: Të ndërtohen aftësitë e institucioneve kombëtare në metodologji për të zhvilluar ose përshtatur udhërrëfyesit klinik; Të nxisë mjekimet bazuar në evidencat e profesionistëve të shëndetit riprodhues; Të ofrojë njohuri dhe mjete se si të monitorohen dhe vlerësohen zbatimi i protokolleve klinike dhe standardeve; Të promovojë standardet dhe cilësinë në kujdesin shëndetësor.

➤ **DY TRAJNIME NJË DITORE MBI “NDIHMA PËR NËNAT QË MBIJETOJNË NGA HEMORRAGJIA PAS LINDJES” “KUJDESI THËLBËSOR PËR TË GJITHA BEBET” DHE “KUJDESI THELBËSOR PËR BEBET E VOGLA”**

Për të ngrituraftësitë thelbësore të ofruesve të kujdesit shëndetësor janë zhvilluar dy trajnime njëditore në rajonin e Lezhës dhe Elbasanit mbi “Ndihma për Nënën që Mbijetojnë nga Hemorragjia pas Lindjes”, “Kujdesi Thëlbësor për të gjitha Bebet” dhe “Kujdesi Thëlbësor për Bebet e Vogla”. Kurrikula dhe aktivitetet u hartuan për të ndihmuar ofruesit e kujdesit shëndetësor për të ruajtur dhe përmirësuar njohuritë dhe aftësitë përmes rishikimit dhe praktikës. Këto trajnime janë bazuar në udhëzimet e miratuara nga Shoqata Amerikane "LDS Charities".



- “Ndihma për Nënën që Mbijetojnë nga Hemorragjia pas Lindjes”, “Kujdesi Thëlbësor për të gjitha Bebet” dhe “Kujdesi Thëlbësor për Bebet e Vogla” " përfshiu 75 pjesëmarrës në qytetin e Lezhës dhe të Elbasanit. Të gjithë pjesëmarrësit ishin nga Materniteti i të dy rajoneve.

Rekomandime:

- Shtrirja e trajnimit në nivel kombëtar.



- Ndihmë dhe mbështetje për ofruesit e trajnuar të shëndetit për të trajnuar dhe ndarë njohuritë dhe aftësitë e fituara me kolegët e tyre.

- Disponueshmëria e materialeve është një domosdoshmëri.

- Përmirësim të kujdesit që mund të kenë nevojë për ndryshime të vogla në mjedisin ku ndodhin lindjet dhe ku fëmijët marrin kujdes

➤ **TRAJNIMI ONLINE DHE OFLINE MBI PLANIFIKIMIN FAMILJAR**

Rezultatet

Trajnimi është përbërë nga 4 module gjatë periudhës 15 gusht deri 15 shtator.

Moduli 1 - Metodat Kontraceptive 1- 41 Pjesëmarrës e përfunduan.

Moduli 2- Metodat kontraceptive 2- 36 pjesëmarrës e përfunduan.

Moduli 3 - Kontracepcioni në praktikë. - 38 pjesëmarrës e përfunduan

Moduli 4 - Çështjet kyçe në metodat e kontracepsionit. - 34 pjesëmarrës e përfunduan.

- Gjithsej 99 pjesëmarrës aplikuan për të qenë pjesë e trajnimit online, por jo të gjithë zgjodhën të përfundojnë çdo modul.

Trajnime me Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor për Metodatat Moderne të Planifikimit Familjar

- 54 ofrues të kujdesit primar shëndetësor u trajnuan në një trajnim dy ditor mbi Planifikimin Familjar të organizuar në rajonet e Fierit dhe Elbasanit me ofruesit e kujdesit shëndetësor publik.



Titulli: Organizimi i tryezës së rrumbullakët të Udhezuesit Teknik Nderkombetar(ITG)-së dhe grupit të ekspertëve, ku vërejtjet / sugjerimet nga ITG-ja u prezantuan me pjesëmarrjen e agjencive të Kombeve të Bashkuara. / Dorëzimi në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – (financuar nga) UNFPA

➤ **Rezultatet**

- 12 lektorë kanë marrë pjesë në seminarin e organizuar së bashku me UNFPA dhe specialistët e çështjeve gjinor për t'u konsultuar për përfshirjen e temave dhe leksioneve specifike në lëndë të ndryshme që janë pjesë e programit Bachelor dhe Master në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.
- E gjithë paketa me udhëzimet thelbësore dhe SOP-të është rishikuar dhe është bërë gati për tu dorëzuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të vazhduar me hapa të tjerë deri në miratimin e saj. Me miratimin e paketës, QSHPZH-ja në bashkëpunim të ngushtë me UNFPA planifikon të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për zbatimin e saj nga Sektori Shëndetësor dhe një pjesë e sektorit social, kështu që gjatë janarit 2019, do të punojnë për përgatitjen e planit vjetor të punës, i nevojshëm për këtë qëllim.



- Gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër DHBGJ dhe “OrangeYourDay”, shumë aktivitete u zhvilluan në Rajonin e Vlorës të organizuar nga QSHPZH-ja dhe bashkëpunim të ngushtë me partnerë të tjerë, Bashkia e Vlorës, Universiteti i Vlorës, Drejtoria Rajonale e Shëndetit, Qendra Vatra, Qendra Rinore Vlora.

- Ndriçimi Portokalli i Universitetit të Vlorës;

- Marshimi i OJF-ve në mbështetje të punës dhe veprimit kundër DHBGJ


<https://youtu.be/1lyzeNzuEI>

- Aktivitete ndërgjegjësimi në mjediset e shkollës;
- Transmetimi i sloganeve të “Dëgjo mua” një fushatë shumë e madhe në qendër të qytetit gjatë 16 ditëve.



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHYVILLIMIN
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

SHERBIMET KLINIKE:



Të Ardhurat

I. Fonde nga donatorët		in 000/leke
IPPF		19,916,101,52 Leke
UNFPA		4,404,660,35 Leke
Olaf Palme		2,605,323,40 Leke
Save the Children		912,821,23 Leke
II. Të ardhura të tjera		
ACPD – të ardhura nga shërbimi në qendrat e grave dhe nga interest bankar		1,517,096,70 leke

FONDET NGA DONATORET DHE FONDI I GJENERUAR NGA ACPD (LEKË) -2018

